



# Të Kuptuarit e Krimeve të Urrejtjes

**osce** Organization for Security and  
Co-operation in Europe  
OSCE Mission in Kosovo

**osce**  
ODIHR







# Të Kuptuarit e Krimeve të Urrejtjes





Botuar nga Zyra e OSBE –së për Institucione Demokratike dhe  
të Drejta të Njeriut (ODIHR)  
Ulica Moidowa 10  
00-251 Warsaw  
Poland  
[www.osce.org/odih](http://www.osce.org/odih)

© OSCE/ODHIR 2011

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret  
dhe kopjohet lirshëm për qëllime arsimore dhe qëllime tjera jo-komerciale,  
me kusht që çdo ribotim apo riprodhim ta përmend OSBE/ODIHR si burim.

ISBN 978-92-9234-795-6

Dizajni: Beate Wegner

Shtypur nga: Misioni i OSBE-së në Kosovë





## PËRMBAJTJA

---

Çka është <b>KRIMI I URREJTJES?</b>	7
Pse <b>KRIMET E URREJTJES</b> duhet të trajtohen ndryshe nga krimet tjera?	9
Si të identifikohet <b>KRIMI I URREJTJES?</b>	10
<b>Reagimet e agjencive të zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë</b>	11
<b>Reagimet e autoriteteve vendore</b>	13
<b>Standardet ndërkombëtare dhe rajonale</b>	14





## Të Kuptuarit e Krimeve të Urrejtjes

### HYRJE

Krimet e urrejtjes janë krime të bazuara në paragjykitje dhe si të tilla ato ndodhin çdo kund. Asnjë shoqëri nuk është imune ndaj efekteve të paragjykitimit dhe jo-tolerancës. Krimet individuale të bazuara në urrejtje paraqesin burim të mundshëm të konfliktit, pasi që mund të përshkallëzohen si në kuptimin e numrit të incidenteve ashtu edhe në nivelin e dhunës. Nëse kjo kuptohet dhe ndërmerren masa të fuqishme, cikli i dhunës mund të ndalet.

Kjo broshurë synon të ndihmojë policinë, prokurorët, gjyqtarët, ligjvënësit, autoritetet lokale dhe OJQ-të të kuptojnë më mirë problemin e krimeve të urrejtjes. Kjo shpjegon rëndësinë e krimeve mbi bazë të urrejtjes dhe sugjeron mënyrat se si autoritetet dhe komunitetet mund të parandalojnë dhe të reagojnë më mirë ndaj këtyre krimeve.

Kjo broshurë është përgatitur nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR), në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë. Ky nuk është udhëzues gjithëpërfshirës mbi krimet e urrejtjes. Për ata që kërkojnë informata të mëtejshme, Sistemi Informativ për Tolerancë dhe Mos-Diskriminim (<http://tandis.odihr.pl/>) ofron një numër mjetesh dhe udhëzimesh të specializuara në gjuhë të ndryshme.





## Çka është **KRIM I URREJTJES?**

Krimet e motivuara nga jo toleranca ndaj grupeve të caktuara në shoqëri përshkruhen si krime të urrejtjes.

Krimet e urrejtjes përbëhen nga dy elemente:

→ *Vepra së pari duhet të jetë vepër penale sipas Kodit Penal.*

→ *Krimi duhet të jetë kryer me një motiv të paragjykuar.*

“Motivi i paragjykuar” nënkupton që kryesi ka zgjedhur cakun e krimit në bazë të disa *karakteristikave të mbrojtura*.

→ *Cak mund të jetë një person, grupim apo prona që ndërlidhen me një grup që ndajnë karakteristika të mbrojtura të përbashkëta.*

→ *Karakteristika e mbrojtur është karakteristikë themelore apo thelbësore e një grupi të përbashkët, si “raca”, feja, etnia, gjuha apo orientimi seksual.*

## Krimi + motivi i paragjykuar = **KRIM I URREJTJES**

Për të kryer një krim të urrejtjes, nuk është e nevojshme që kryesi të ndjejë urrejtje. Mjafton që krimi të jetë kryer nga motivi i paragjykuar. Paragjykimi nënkupton që personi ka ide të paragjykuara ndaj një personi apo grupi. Meqë shkak për kryerjen e krimeve të urrejtjes është ajo që përfaqëson personi, njerëzit apo pronat në fjalë, kryesi mund të mos ketë fare ndjenjë ndaj një viktime individuale.

### **Një rast ilustrues:**

*Adoleshentët shkojnë në varrezat e hebrenjve ku shqelmojnë disa gurë varresh dhe shkarravisin disa të tjerë duke vendosur kryqet e thyer. Gurët e varreve zgjedhën rastësisht.*

Ky paraqet një krim të urrejtjes. Mbishkrimet janë provë e motivit të paragjykuar edhe pse urrejtja e autorëve të krimit nuk përqendrohet në persona të veçantë.

### **Ilustrimi tjetër:**

*Një varr në varrezat ortodokse serbe u përdhos një ditë pas varrimit. Arkivoli është nxjerrë dhe është dëmtuar shumë. Varrri ishte i serbit të parë nga Kosova që u varros në Kosovë pas konfliktit të vitit 1999, dmth. para më shumë se 10 viteve.*

Koha e incidentit, një ditë pas varrimit, si dhe fakti që nuk mungonte asnjë





pronë materiale, flasin për motivin e paragjykuar të kryesve ndaj komunitetit serb të Kosovës. Komuniteti e ka kuptuar këtë incident si porosi që anëtarët e tyre të familjes nuk duhet të varrosen në varrezat ortodokse në qytet. Familja ka kërkuar që trupi të zhvarrosset dhe të bartet në një varrezë tjetër në një fshat të banuar me serbë në Kosovë.

## LIGJET MBI KRIMET E URREJTJES NË KOSOVË<sup>1</sup>

Në Kosovë, dispozitat e kufizuara në Kodin Penal autorizojnë shqiptimin e dënimeve më të rënda për krimet që kryhen me motiv të paragjykuar.<sup>2</sup>

Për shembull, Kodi Penal përmban dispozita të veçanta për vrasjen e rëndë<sup>3</sup> dhe dëmtimin e pronës së luajtshme kur ato kryhen me motiv të paragjykuar.<sup>4</sup> Kodi Penal ka edhe dispozitat për rrethana lehtësuese dhe rënduese që zbatohen për të gjitha krimet. Këto dispozita i mundësojnë gjyqtarëve të marrin parasysh motivet e kryerjes së veprës penale, të cilat mund të përfshijnë motivin e paragjykuar, kur të vendosin për dënimin.<sup>5</sup>

Kosova ka edhe dispozita të ndara mbi veprat kundër prishjes së rendit publik të cilat penalizojnë nxitjen e urrejtjes, përçarjes apo jo tolerancës kombëtare, racore, fetare apo etnike,<sup>6</sup> si dhe dispozitat penale kundër diskriminimit.

### *Viktimat e krimit të urrejtjes*

Secili person mund të jetë viktimë e krimit të urrejtjes, megjithëse pjesëtarët e komuniteteve pakicë janë viktimat më të shpeshta. Krimet e urrejtjes gjithashtu kanë si shënjestër pronat që i përkasin apo që ndërlidhen me një komunitet, si objektet e kultit.

Të gjitha krimet e urrejtjes duhen trajtuar me seriozitet të njëjtë, pa marrë parasysh kush është viktima apo kryesi.

1 Nuk ka konsensus në mesin e shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së për statusin e Kosovës dhe, si e tillë, Organizata nuk ka një pozicion për këtë çështje<sup>1</sup>

2 Përdorimi i këtyre dispozitave shpesh rezultojnë në kualifikime të pasakta juridike dhe zbatim jokonsistent.

3 Kodi penal, Neni 147(6).

4 Kodi Penal, Neni 260(2).

5 Kodi Penal, Neni 64 (1).

6 Kodi Penal, Neni 115. Ekzistojnë dispozita të ngjashme në Nenin 4 të Ligjit për liritë fetare në Kosovë, si dhe Nenin 6(8) të Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve.







## CAQET E KRIMEVE TË URREJTJES NË KOSOVË

Krimet e urrejtjes në Kosovë shpesh kanë cak:

- Të kthyerit dhe pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë<sup>7</sup>, të cilët shpesh janë të izoluar dhe të cenuar. Krimet nga urrejtja kundër këtyre pjesëtarëve të komuniteteve përçojnë mesazhe të fuqishme të jo tolerancës dhe shkaktojnë nivele të larta të frikës.
- Objektet fetare dhe të shenjta, si kishat, xhamitë e varrezat, si dhe pronat private që i përkasin të kthyerve apo pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë.
- Shenjat dhe sinjalizimet rrugore në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë që shpeshherë vandalizohen dhe shkarraviten. Dëmtimi i objekteve të tilla publike përçon mesazhe të jo tolerancës në gjithë komunitetin.
- Pjesëtarët e pakicave seksuale. Pjesëtarët e këtij grupi janë tejet të cenueshëm ndaj krimeve nga urrejtja. Shpeshherë ndodhin raste të sulmeve jashtë bareve apo klubeve të natës të homoseksualëve.

## Pse duhet që **KRIM I URREJTJES** të trajtohen ndryshe nga krimet tjera?

**Krimet e urrejtjes kanë tendencë të rriten:** Për shkak se kryesit ndjejnë se veprojnë në emër të komunitetit të tyre, ata ndjejnë se sjellja e tyre është e arsyeshme. Nëse ky komunitet nuk e dënon dhe nuk hedh poshtë në mënyrë efektive krimin e urrejtjes, këta të parët dhe autorët e tjerë të krimit të mundshëm trimërohen të vazhdojnë veprimet e tyre, dhe numri i krimeve të urrejtjes rritet.

**Krimet e urrejtjes kanë tendencë të përshkallëzohen:** Kryesit që fillojnë të kryejnë vepra kundërvajtjeje shpesh vazhdojnë të kryejnë akte përherë më të dhunshme nëse nuk kapen dhe nuk ndalohen. Kështu, edhe kundërvajtjet që bëhen me motivim animi apo paragjykimi janë të rrezikshme dhe kërkojnë reagime të fuqishme.

**Krimet e urrejtjes kanë tendencë të krijojnë spirale dhune:** Nëse viktimat dhe komunitetet e tyre ndjehen të pasigurt dhe të pambrojtur nga autoritetet e rendit, është e pritshme që ata të hakmerren ndaj anëtarëve të komunitetit i cili fajësohet për sulme ndaj tyre. Kjo mund të çojë në sulme tjera, gjë që krijon një spirale dhune e cila përfundimisht çon në përçarje serioze shoqërore. Në vendet me histori konfliktesh etnike, ky fenomen është veçanërisht i pranishëm.

<sup>7</sup> Për qëllimet e kësaj broshure, komunitetet jo-shumicë janë të gjitha ato komunitete që përbëjnë pakica numerike në nivelin komunal në Kosovë.





## Si të identifikohet KRIM I URREJTJES?

Indikatorë të paragjykimit janë një apo më shumë fakte që tregojnë se krimi mund të jetë kryer me motiv të paragjykuar. Ata ofrojnë kritere objektive me të cilët gjykohej motivet e mundshme, por jo detyrimisht vërtetojnë që veprimet e kryesit ishin të motivuara nga paragjykimi. Indikatorët e paragjykimit duhet të përdoren për të vendosur nëse duhet hetuar më tutje qëndrimet dhe motivet e kryesit të krimit.

Indikatorët e paragjykimit janë të dobishëm për policinë, prokurorinë dhe OJQ-të kur analizojnë nëse një krim i denoncuar mund të jetë krim nga urrejtja. Shumë vende dhe organizata kanë hartuar një mori të indikatorëve të tyre të paragjykimit. Një listë jo-gjithëpërfshirëse e indikatorëve të animit është dhënë në vijim:

### ***Perceptimi i viktimës/dëshmitarit***

→ A e percepton viktima ose dëshmitari incidentin se ka qenë i motivuar nga paragjykimi?

### ***Komentet, deklaratat me shkrim, gjestet apo mbishkrimet***

→ A ka bërë i dyshuari komente, deklarata me shkrim apo gjeste në lidhje me komunitetin e viktimës?

→ A ka pasur vizatime, shenja, simbole apo mbishkrime që janë lënë në vendngjarje të incidentit?

→ Nëse caku ka qenë prona, a ka qenë objekt apo vend me rëndësi fetare apo kulturore, si monument historik apo varrezë?

### ***Dallimet racore, etnike, gjinore dhe kulturore***

→ A dallojnë i dyshuari dhe viktima në kuptimin racor, fetar dhe etnik/kombëtar apo në orientimin seksual?

→ A ka histori armiqësie mes grupit të viktimës dhe atij të të dyshuarit?

→ A është viktima anëtar i një grupi që është tejet i mbizotëruar me numër nga anëtarët e një grupi tjetër në zonën ku ka ndodhur incidenti?

→ A ka qenë viktima e angazhuar në aktivitete të promovimit të grupit të tij/saj në kohën e incidentit?

→ A ka ndodhur incidenti në ndonjë datë të caktuar (p.sh. festë fetare apo ditë kombëtare?)

### ***Grupet e organizuara të urrejtjes***

→ A lënë për të dyshuar objektet apo gjërat e lëna në vendin e krimit që kjo ka qenë vepër e një organizate paraushtarake apo ekstremiste?

→ A ka prova që një grup i tillë të jetë aktiv në lagje (p.sh. afishe, mbishkrime apo trakte?)





### ***Krimet/incidentet e mëhershme të paragjykit***

- A ka pasur incidente të ngjashme në të njëjtën zonë? Kush kanë qenë viktimat?
- A ka pranuar viktima ndonjë korrespondencë apo telefonatë ngacmuese, apo a ka qenë viktimë e abuzimit verbal në bazë të përkatësisë apo anëtarësisë në një grup të caktuar?
- A ka qenë viktima në apo afër një zone apo vendi që gjerësisht ndërlidhet apo frekuentohet nga një grup i caktuar (p.sh. qendër e komunitetit apo xhami, kishë apo vend tjetër i kultit)?

## **KRIMET E LUFTËS, GJENOCIDI DHE KRIMET NGA URREJTJA**

Krimet e luftës dhe gjenocidi shpesh janë krime me motiv paragjykimi. Megjithatë, pasi krimet e luftës dhe gjenocidi janë shkelje e të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe kanë të bëjnë me bashkësinë ndërkombëtare si tërësi, ato nuk bëjnë pjesë në rubrikën e krimeve të urrejtjes. Krimet e luftës dhe gjenocidi shpesh ndiqen penalisht nga gjykata ndërkombëtare apo speciale.

Një faktor tjetër dallues është që disa krime lufte dhe gjenocidi kërkojnë prova të një qëllimi të caktuar (gjenocidi për shembull kërkon prova të qëllimit të shkatërrimit të plotë apo të pjesshëm të grupit të caktuar) përtej provës së paragjykit që kërkohet për krimet e urrejtjes.

## **Reagimet e agjencive të zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë**

Në shumicën e rasteve, vërtetimi i motivit në një krim nuk është i domosdoshëm. Pasi motivi është çështje komplekse dhe ka kufij mbi llojet e provave që mund të përdoren për vërtetimin e tij, rastet e krimeve të urrejtjes kërkojnë një qasje ndryshe nga policia, prokurorët dhe gjyqtarët për dallim prej rasteve tjera.

## **GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar që shtetet kanë obligime pozitive për të hetuar thellësisht motivimin e mundshëm racor prapa atyre krimeve. Ajo ka theksuar, në rastin **Šečić kundër Kroacisë**:

*“...Autoritetet shtetërore kanë për detyrë shtesë që të ndërmarrin gjithë hapat e arsyeshëm për zbulimin e motiveve të mundshme racore, si dhe të përcaktojnë*





*nëse urrejtja etnike apo paragjykimi ka mundur të ketë pasur rol në këtë rast.” Dështimi për ta bërë këtë dhe, “...trajtimi i dhunës dhe brutalitetit të nxitur nga motivi racor në mënyrë të barabartë me rastet që nuk kanë motiv racor do të ishte mbyllje e njërit sy ndaj natyrës specifike të veprave që janë veçanërisht shkatërruese për të drejtat themelore.”<sup>8</sup>*

### ***Policia:***

Për të hetuar në mënyrë efektive krimet e urrejtjes dhe për të grumbulluar të dhëna, policia duhet të jetë në gjendje t'i identifikojë së pari krimet e urrejtjes. Treguesit e paragjykimit janë mjete thelbësore. Kur të intervistohen kryesit, atëherë duhet të hulumtohen edhe motivet. Shumë kryes të krimit pranojnë haptas motivimin e tyre, sepse ndjejnë që sjellja e tyre është e arsyetuar dhe e mirëpritur nga pjesa më e madhe e komunitetit të tyre.

Grumbullimi i të dhënave për krimet e urrejtjes është mjet kyç i zbatimit të ligjit. Kjo i mundëson autoriteteve të vërejnë se ku janë duke u krijuar problemet, cilat lokacione mund të kërkojnë mbrojtje më të madhe për parandalimin e krimeve të ardhshme, si dhe cilat komunitete kanë nevojë për sigurim shtesë. Grumbullimi i të dhënave siguron intelegjencë të shtuar dhe mundëson shpërndarjen e duhur të resurseve.

### ***Prokurorët:***

Prokurorët duhet të ndërtojnë aktakuzën sipas dispozitave për krimet e urrejtjes (nëse ka të tilla) në kode penale, kudo që është e mundur. Në çdo rast, sado i vogël të jetë ai, prokurorët duhet të trajtojnë veprën si të rëndë nëse ka motiv të tillë. Kjo duhet të çojë tek grumbullimi dhe parashtrimi i provave të motivit para gjykatës, edhe nëse nuk ka formë të rëndë të krimit të shënuar në kod. Në mungesë të pranimit, prokurorët mund të marrin parasysh format tjera të provave:

- *Krimet e urrejtjes shpesh shoqërohen me ofendime verbale apo mbishkrime në vendngjarje të krimit – provë qenësore e motivit.*
- *Nëse muzika, literatura, faqet e internetit ose postimet në internet, veshmbathja, bizhuteritë apo tatuazhet e kryesit tregojnë anëtarësinë apo mbështetjen për grupe ekstremiste, kjo është provë relevante për qëndrimet e përgjithshme të tij/saj.*
- *Mund të ketë pasur veprime të mëhershme të ngjashme të kryera nga kryesi, ndaj kësaj viktime apo të tjerëve.*

<sup>8</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Šečić kundër Kroacisë, kërkesa Nr. 40116/02, paragrafët 66-67, 31 maj 2007.





### **Gjykatat:**

Aty ku krimi nga urrejtja vërtetohet, dënimi duhet rritur për të reflektuar motivimin dhe ndikimin e mundshëm të krimit në komunitet, përtej viktimës. Për të rritur ndikimin e kësaj, gjykatësit duhet të theksojnë në gjykatë të hapur dhe në aktgjykim që motivi ka çuar në rritje të dënimit.

### **Angelova dhe Iliev kundër Bullgarisë (2005)**

Më 1996, Z. Angel Iliev kishte vdekur pas një rrahjeje dhe një therjeje me thikë nga një grup adoleshentësh. Sulmuesit ishin arrestuar brenda disa orëve. Ata pohuan të kishin kërkuar romë për t'i sulmuar dhe kishin shprehur urrejtjen e tyre ndaj romëve dhe pakicave tjera. Pesë nga sulmuesit ishin akuzuar për "huliganizëm me një cinizëm dhe paturpësi të tepruar", por për nëntë vjet, asgjë nuk ishte bërë për t'i dorëzuar ata para drejtësisë. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut kishte theksuar që Bullgaria kishte shkelur obligimet e saj për mbrojtjen e të drejtave dhe përndjekjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut, si dhe ishte "plotësisht e papranueshme" që përkundër njohurisë për motivet raciste të autorëve, kishte ndodhur një dështim i tillë në dorëzimin e rastit para drejtësisë në mënyrën më të shpejtë.<sup>9</sup>

## **Reagimet e autoriteteve vendore**

**Ekzistojnë shumë dobi nga përmirësimi i reagimit ndaj krimeve të urrejtjes:**

**Paralajmërimi i hershëm:** Trazirat serioze të dhunshme shpesh nxiten nga një incident i vetëm, i vogël, i motivuar me paragjykim, që i zë autoritetet në befasi. Njohja dhe përndjekja e krimeve të urrejtjes i mundëson agjencive të zbatimit të ligjit të parashikojnë shpërthimin e incidenteve të rënda.

**Komunitete më të fuqishme:** Identifikimi dhe dënimi i krimeve të urrejtjes ngrit vetëbesimin e komuniteteve të prekura, si rritja e besimit tek sistemi i drejtësisë penale si dhe ndjenjës së sigurisë tek komunitetet.

**Inteligjencë e avancuar:** Me rritjen e besimit tek policia, po ashtu rriten edhe informatat dhe bashkëpunimi i atyre komuniteteve që preken nga krimet e urrejtjes. Marrëdhëniet e mira me komunitetin ndihmojnë në suksesin e hetimeve, jo vetëm në rastet e krimeve të urrejtjes, por edhe në çështje tjera në të cilat policia kërkon ndihmën e komunitetit.

<sup>9</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Angelova dhe Iliev kundër Bullgarisë, Kërkesa Nr. 55523/00, 26 korrik 2007.





## REAGIMI NDAJ KRIMIT TË URREJTJES

### Ekzistojnë disa praktika të mira që mund të ndërmerren nga autoritetet vendore:

- Mënjanimi i shpejtë i mbishkrimeve ofenduese me përmbajtje të motivuar nga paragjykimi. Ky është hap i vogël, por i rëndësishëm në përmirësimin e besimit të komunitetit.
- Përafrimi i menjëhershëm i zyrtarëve komunalë me komunitetet e prekura si dhe shfrytëzimi i forumeve të sigurisë në komunitet për t'i mundësuar komunave dhe agjencive lokale të zbatimit të ligjit për t'u takuar me shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e komunitetit për të shkëmbyer informata dhe çështje brengosëse.
- Kur ndodhin incidente që dyshohen të jenë të motivuara nga paragjykimi, duhet të sigurohet që kryetarët e komunave dhe politikanët lokalë të garantojnë komunitetin që do të bëhet një hetim i hollësishëm dhe që të bëjnë deklaratat pozitive publike. Është me rëndësi që të njihen brengat e komunitetit dhe që të shpjegohet se çfarë masash po ndërmerren. Deklaratat e tilla merren më seriozisht nëse ka një vazhdimësi të përsëritjes si dhe puna me organizatat e komunitetit.
- Promovimi i projekteve shkollore për të edukuar nxënësit në lidhje me krimet e urrejtjes si dhe luftimi i ngacmimeve të mundshme të motivuara nga paragjykimi. Kjo mund të jetë pjesë e lëndës së edukimit qytetar, siç është edhe “binjakëzimi” me shkollat tjera në zonën lokale apo në një zonë etnikisht më të përzier, organizimi i aktiviteteve të përbashkëta për të hulumtuar paragjykimet dhe përvojat e ndërsjella.
- Edukimi sistematik për të gjithë nxënësit në lidhje me paragjykimin dhe mosdurimin (jo tolerancën). Kjo mund të arrihet nëse autoritetet e arsimit sigurojnë që lënda të bëhet pjesë përbërëse e planprogrameve shkollore dhe fakulteteve të edukimit, klasët, siç janë “binjakëzimi” me shkollat tjera në zonat lokale ose në zonat me përkatësi etnike të ndryshme që të organizohen aktivitete të përbashkëta që të hulumtohen paragjykimet dhe përvojat reciproke.

## Standardet ndërkombëtare dhe rajonale

Ekziston një organ gjithëpërfshirës i instrumenteve ndërkombëtare dhe rajonale të cilat nxjerrin detyrime të qarta për shtetet në reagimet e tyre ndaj krimeve të urrejtjes.





Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor po ashtu kërkon nga shtetet të zbatojnë ligjet të cilat i dënojnë krimet e motivuara nga racizmi. Vendimi Kornizë i BE-së për Luftimin e Racizmit dhe Ksenofobisë është relevant për shtetet anëtare të BE-së si dhe për secilin vend që mëton anëtarësimin në të ardhmen. I miratuar nga BE-ja në vitin 2008, ky Vendim Kornize synon të ndërtojë një qasje të përbashkët penale ligjore ndaj krimeve të urrejtjes, duke përfshirë dënimet e rënda për motivim nga paragjykimi.

Në lidhje me zbatimin e ligjit, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar që shtetet kanë për detyrë të hetojnë në masë të duhur motivimet potenciale racore të krimeve. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë përkushtuar të garantojnë se legjislacioni i tyre është adekuat, duke grumbulluar statistika, duke siguruar që krimet e urrejtjes janë të hetuara dhe përndjekura tërësisht, si dhe duke ofruar trajnime kudo që është e nevojshme.



